

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, koleji i përbërë nga gjyqtarët: Shukri Sylejmani, kryetar, Erdogan Haxhibeqiri dhe Emine Kaçiku, anëtarë, në çështjen juridike të paditëses–kundërpaditurës (më tutje vetëm paditëses) R. Sh., nga Gjilani, kundër të paditurit–kundërpaditësit (më tutje vetëm të paditurit) S. Q., nga Komuna e Lipjanit, për shkak të besimit të fëmijëve, në mbajtje, ruajtje , dhe edukim , duke vendosur sipas revizionit të paditurit, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit në Prishtinë, Ac.nr.4432/2014 datë 11.11.2016, në seancën e kolegjit të mbajtur më 8.3.2017, merr këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si i pabazuar revizioni i të paditurit, i paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit në Prishtinë, Ac.nr.4432/2014, datë 11.11.2016.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit në Prishtinë, Ac.nr.4432/2014 datë 11.11.2016 është refuzuar si e pabazuar ankesa e të paditurit dhe është vërtetuar aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Lipjan, C.nr.9/2014 datë 25.9.2014 me të cilin në pjesën I të dispozitivit është aprovuar kërkesëpadia e paditëses dhe fëmijët e mitur H. Sh., e lindur më datë 14.12.2009, dhe Rr. Sh., i lindur më 8.12.2010, të lindur në bashkësi jashtëmartesore të ndërgjyqësve, i besohen në mbajtje, ruajtje dhe edukim paditëses si nënë, deri në ndryshimin e rrethanave në bazë të cilave është vendosur me këtë aktgjykim. Me pjesën II të dispozitivit është caktuar

kontakti i këtyre fëmijëve me të paditurin si baba i tyre, dy herë në muaj dhe atë çdo të dytin vikend të muajit nga ora 15, ditë e premte, deri në orën 9 të ditës së hënë, si dhe ditën e dytë të festave fetare dhe zyrtare dhe ditëlindjeve të fëmijëve. Kontakti realizohet përmes Qendrës për Punë Sociale në Gjilan. Në rast të pamundësisë së mbajtjeve të kontakteve sipas këtij orari, i njëjti kontakt mund të realizohet ndryshe nga ajo siç është caktuar më lartë me marrëveshje të palëve ndërgjyqëse. Me pjesën III të dispozitivit është detyruar i padituri që paditësit t’ia paguaj shpenzimet e procedurës në shumë prej 636 €, dhe me pjesën IV të dispozitivit është refuzuar si e pabazuar kundërkërkesëpadia e të paditurit që fëmijët e lartpërmendur, atij t’i besohen në mbajtje, ruajtje dhe edukim.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, i padituri me kohë ka paraqitur revizion për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të dy aktgjykimet e lartpërmendura të prishen dhe lënda të kthehet në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë ose të njëjtat aktgjykime të ndryshohen ashtu që kundërkërkesëpadia e të paditurit të aprovohet si e bazuar, ndërsa kërkesëpadia e paditëses të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, në kuptim të nenit 215 të Ligjit për Procedurë Kontestimore (LPK), shqyrtoi aktgjykimin e goditur me revizion dhe gjeti se:

Revizioni i të paditurit është i pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se i padituri edhe pse ka qenë në martesë me një bashkëshorte tjetër, për shkak të mungesës së fëmijëve, ka themeluar bashkësi jashtëmartesore në vitin 2008 me të paditurën. Në këtë bashkësi jashtëmartesore iu kanë lindur dy fëmijët e përbashkët, H. Sh., më datë 14.12.2009 dhe Rr. Sh., më datë 8.12.2010. Ndërkohë ka ngelur shtatzënë bashkëshortja e parë e të paditurit dhe që atëherë kanë filluar mosmarrëveshjet e tyre të cilat kanë rezultuar me ndarjen nga njëri tjetri në vitin 2011, me ç’ rast paditësja ka shkuar në familje të saj, ndërsa fëmijët kanë ngelur në mbajtje, ruajtje dhe edukim të mëtejme tek i padituri, si baba. Ndërkohë të paditurit dhe bashkëshortes së tij të parë iu lind një fëmijë.

Gjykata e shkallës së parë ka administruar provat e nevojshme për të vendosur lidhur me kërkesëpadinë e paditëses, e cila kërkon që fëmijët t'i besohen në mbajtje, ruajtje dhe edukim, dhe kundërkërkesëpadinë e të paditurit i cili kërkon që atij t'i mbeten edhe më tutje fëmijët në mbajtje, ruajtje dhe edukim, ka marrë mendimin e Qendrës për Punë Sociale në Gjilan dhe Qendrës për Punë Sociale në Lipjan, dhe mendimin e psikologut për fëmijë, e po ashtu ka dëgjuar edhe ndërgjyqësit në cilësi të palës, dhe pas vlerësimit të këtyre provave ka gjetur se kërkesëpadia e paditëses është e bazuar, ndërsa kundërkërkesëpadia e të paditurit është e pabazuar.

Gjykata e shkallës së dytë, në procedurën ankimore ka refuzuar si të pabazuar ankesën e të paditurit dhe ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, duke pranuar si të bazuara të gjitha konstatimet faktike dhe juridike të së njëjtës gjykatë.

Gjykata Supreme e Kosovës pranon si të bazuar qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë lidhur me aprovimin si të bazuar të kërkesëpadiës së paditëses, dhe refuzimin e kundërkërkesëpadiës së të paditurit, kjo ngase aktgjykimet e tyre nuk përfshihen me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore në të cilat gjykata e revizionit në kuptim të nenit 215 të LPK-së kujdeset sipas detyrës zyrtare, e as me zbatim të gabuar të së drejtës materiale.

Objekt shqyrtimi në gjykatën e revizionit ishin pretendimet e të paditurit për shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore të cilat sipas të paditurit qëndrojnë në atë se nga gjykatat e lartpërmendura nuk janë theksuar se cilat ishin faktet vendimtare për aprovim të kërkesëpadiës dhe refuzim të kundërkërkesëpadiës, se pjesa II dhe III e dispozitivit përkitazi me kontaktin e caktuar të paditurit me fëmijët dhe për shpenzimet e procedurës, është e paqartë. Këto pretendime të revizionit, u refuzuan si të pabazuara, ngase gjykatat e lartpërmendura kanë konstatuar se në bazë të mendimit të Qendrës për Punë Sociale në Gjilan dhe mendimit të psikologut për fëmijë, duke çmuar edhe faktet tjera të rëndësishme, kanë vendosur që të aprovohet kërkesëpadia e paditëses, duke gjetur se për shkak të moshës së tyre, është në interes të këtyre fëmijëve që të rriten me nënën e tyre, dhe se ndryshimi i ambientit jetësor prej babait,

duke filluar të jetojnë në një ambient tjetër jetësor tek nëna e tyre, nuk ndikon në mënyrë negative në zhvillimin psikik të këtyre fëmijëve, normalisht duke pasur kontakte të mëtejme edhe me babanë e tyre-të paditurin. Pretendimet e revizionit për paqartësi të dispozitivit në pjesën e II dhe III të dispozitivit, nuk qëndrojnë, përkundrazi Gjykata Supreme vlerëson se dispozitivi i aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë në tërësi është i qartë, jo kundërthënës dhe i zbatueshëm, e aq më tepër nuk është në kundërshtim me provat e administruara si dhe me arsyetimin e dhënë nga gjykata e shkallës së parë.

Pretendimet e revizionit për zbatim të gabuar të së drejtës materiale, ngase paditësja nuk ka shtëpi të veten, nuk është e punësuar dhe është e pasiguar, janë vlerësuar nga të dy gjykatat e shkallës më të ulët, dhe si të tilla janë refuzuar si të pa bazuara. Pretendimet e tilla janë të pabazuara edhe sipas gjykatës së revizionit, ngase me provat nga shkresat e lëndës është vërtetuar se paditësja jeton me vëllezërit në një shtëpi trekatëshe, e siguar materialisht nga vëllezërit e saj të cilët edhe me shkrim kanë shprehur gatishmëri që paditësen ta mbështesin materialisht edhe në mbajtjen, ngritjen dhe edukimin e fëmijëve të saj, kështu që faktet e pretenduara nga revizioni se paditësja nuk posedon me kushte materiale për rritjen e fëmijëve, edhe sipas gjykatës së revizionit nuk janë me rëndësi vendimtare. Pretendimi i revizionit se paditësja është psikikisht jostabile, nuk janë argumentuar, përkundrazi nga raporti psikiatrik në shkresat e lëndës, rezulton se paditësja nuk ka çrregullime psikike.

Për arsyet e paraqitura më lartë, revizioni i të paditurit u refuzua në tërësi si i pa bazuar, andaj në pajtim me nenin 222 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-PRISHTINË

Rev.12/2017, datë 8.3.2017

Kryetari i kolegjit,
Shukri Sylejmani

